

Në bazë të nenit nenit 18 paragrafi (1) alinea 3 dhe neni 20 paragrafi 1 alinea 10¹të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 42/20 dhe 77/21), dhe në lidhje me nenin 41 paragrafi (6) të Ligjit të njëjtit, neni 15 paragrafi (1) alinea 3 dhe nenin 39 paragrafi (1) alinea 10 të Rregullores së punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i pastruar) me nr.ark.01-3732/1 datë 29.7.2019, duke vendosur sipas Njoftimin për ndryshimin e strukturës së pronësisë të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive JON-RADIO SHPK Strugë, PA 1 nr.02-14 datë 9.1.2023, sipas Konkluzionit të Këshillit me nr.ark. 02-321/3 datë 27.1.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive, në seancën e 3 -të mbajtur më 27.1.2023 miratoi si në vijim:

V E N D I M

1. I LEJOHET ndryshim në strukturën e pronësisë Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive JON-RADIO SHPK Strugë, përkatësisht:

- për përfaqësimin e personit fizik Andrej Stojkov, me NVAQ dhe adresë në rrugën, me pjesëmarrje prej 25% në kapital themelor dhe për kalimin e pjesës së tij personit fizik me NVAQ dhe adresë në bulevarin.

2. Detyrohet Shoqëria Tregtare Radiodifuzive JON-RADIO SHPK Strugë, pas kryerjes së ndryshimit përcaktuar në pikën 1 të këtij Vendimi, të dorëzojë në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale gjendjen aktuale e dhënë nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut. .

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

A r s y e t i m

Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) JON-RADIO SHPK Strugë, në pajtim me nenin 41 paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive (LSHMAAV) dhe Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e njoftimit për ndryshim të strukturës së pronësisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.171/14), me Njoftimin për ndryshim të strukturës së pronësisë (PA1 nr.02-14 datë 9.1.2023), e njoftoi Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive (Agjencia) për synimin e tij për zbatim të ndryshimit në strukturën e pronësisë të SHTR JON-RADIO SHPK Strugë .

Njoftimi i dorëzuar për ndryshim të strukturës së pronësisë (PA1 nr. 02-14 datë 9.1.2023), nga ana e SHTR JON-RADIO SHPK Strugë, rezultoi i plotë dhe i rregullt, përkatësisht i përmban të gjitha të dhënat dhe dokumentet e përcaktuara në Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e njoftimit për ndryshim të strukturës së pronësisë.

Për të shqyrtuar nëse ndryshimet e propozuara në strukturën e pronësisë të SHTR JON-RADIO SHPK Strugë do të krijonin një përqendrim të paligjshëm mediatik, gjegjësisht nëse janë në kundërshtim me ndalesat e neneve 34, 35 paragrafi (2) dhe 38 të LSHMAAV, Agjencia ka ofruar "Informacion për subjektet në lidhje (persona të autorizuar, organe drejtuese, pronarë në subjekte të tjera) – gjendja aktuale", nr.0820-50/150020230005608 datë 11.1.2023, nga Sistemi i Shpërndarjes së Internetit të Regjistrat Qendror të RSM-së, nga ku shihet qartë se personi fizik paraqitet si: pronar dhe menaxher i Shoqërisë për tregti, prodhimtari, ndërtim, transport, turizëm dhe shërbime GIV MONT SHPK eksport-import, Gostivar, ku veprimtari prioritar/kodi kryesor i të ardhurave është 41.20 - Ndërtimi i objekteve banesore dhe jo-banesore (ky person juridik nuk figuron si themelues i shoqërive tregtare) dhe të Shoqërisë Tregtare GOZ SERVIS SHPKNJG Gostivar, ku veprimtari prioritar/kodi kryesor i të ardhurave është 43.29 – Ndërtime të tjera dhe punë instalimi

¹Paragrafët 8 dhe 9 janë fshirë, shih: Nenin 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 248/18).

(ky person juridik nuk figuron si themelues i shoqërive tregtare); pronar i Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive JON-RADIO SHPK Strugë (transmetuesi nuk figuron si themelues i shoqërive tregtare); dhe person i autorizuar i filialit të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive JON-RADIO SHPK Strugë.

Po ashtu, Agjencia ka kontrolluar edhe Regjistrin e Pronarëve të Paluajtshëm, të cilin e udhëheq Regjistri Qendror i RSM-së, dhe ka siguruar që gjendja aktuale për personin fizik - pronar i vetëm për, nr. 2007-50/150020230005618 datë 11.1. 2023, të cilat konfirmojnë të dhënat e mësipërme.

Duke pasur parasysh se Agjencia ka konstatuar se zbatimi i ndryshimit të strukturës së pronësisë të SHTR JON-RADIO SHPK Strugë nuk krijon koncentrim të kundërligjshëm mediatik, në kuptimin e LSHMAAV, gjegjësisht se ky ndryshim nuk është në kundërshtim me ndalimin nga nenet 34, 35 paragrafi (2) dhe 38 nga Ligji i njëjtë, pas Njoftimit të dorëzuar për Ndryshimin e Strukturës së Pronësisë, PA1 me nr. 02-14 datë 1.9.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale miratoi vendim si në dispozitiv.

Nr.02.01.2023

30.01.2023

Shkup

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale,
Kryetari i Këshillit,**

Lazo PETRUSHEVSKI d.v

Këshillë juridike : Kundër këtij vendimi transmetuesi, nëse është i pakënaqur me vendimin, ka të drejtë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit të ngrejë padi për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente.

Dorëzuar deri tek :

- Shoqëria Tregtare Radiodifuzive JON-RADIO SHPK Strugë ;
- Drejtuesit të SHTR JON-RADIO SHPK Strugë ;
- Sektorit për planifikim strategjik dhe mbrojtje të së drejtës së autorit;
- Sektorit për çështje juridike dhe furnizime publike dhe
- Personat e emëruar në Agjenci për udhëheqjen e regjistrin PA1.